

VENDIM
Nr. 148, datë 31.3.2000

PËR MËNYRËN E SHITJES SË MALLRAVE TË ARDHURA GRANT NGA JAPONIA NË KUADËR TË PROJEKTIT “SHTIMI I PRODHIMEVE USHQIMORE”, 2KR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shitja e mallrave të ardhura nga Japonia, nëpërmjet projektit “Shtimi i prodhimeve ushqimore”, “2KR, bëhet nëpërmjet ankandit. Dokumentacioni dhe forma e ankandit përcaktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, në mbështetje të vendimit nr.192, datë 20.3.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes”.

Për mallrat që do të mbeten pa u shitur pas zhvillimit të dy ankandeve të njëpasnjëshëm, të aplikohet shitja me këste e mallrave përfituesve nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, nëpërmjet një linje kreditimi me interes zero. Si çmim i shitjes me këste të mallrave të aplikohet çmimi që do të rezultojë në përfundim të ankandit. Kriteret e tjera të përzgjedhjes së përfituesve dhe të shitjes së mallrave me këste përcaktohen me udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe struktura e ngarkuar prej saj për zbatimin e projektit të bashkëpunojnë me sektorin privat, me agroserviset, me shoqatat e agrobiznesit, për projektet e tjera dhe përfituesit, për të garantuar shitjen e shpejtë të mallrave dhe krijimin, në afatin e parashikuar, të fondit kundërparti.

3. Struktura e shpenzimeve të domosdoshme për shitjen e mallrave të ardhura nëpërmjet projektit të sipërpërmendur dhe kthimin e fondit kundërparti përcaktohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për çdo vit, deri në përfundim të projektit të miratuar.

4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrë udhëzimin e zbatimit të projektit “Shtimi i prodhimeve ushqimore”, “2KR.

5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta